L I G J
Nr. 8519, datë 30.7.1999

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8435, DATË 28. 12. 1998 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8435, datë 28. 12. 1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10 paragrafi 14 në fund të tij të shtohen fjalët: "si dhe pensionistët e të sëmurët kronikë që kurohen jashtë shtetit. "

Neni 2

Në nenin 10 shtohet paragrafi 15:
"15. Tregtarët e vegjël dhe banorët e zonave kufitare e paguajnë taksën e solidaritetit në pikat e kalimit kufitar një herë në muaj. "

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2443, datë 19.8.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani